



## **Procesverbal nga mbledhja e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve**

### **Nr. 48**

Datë: 16. 09. 2017, ora: 12:00

Vendi: Selia e KQZ-së/Prishtinë

Kryesues i mbledhjes: Adnan Rustemi, anëtar i KQZ-së

Në mbledhje morën pjesë anëtarët e KQZ: Betim Gjoshi, Ilir Gashi, Adnan Rustemi, Binak Vishaj, Eshref Vishi, Ercan Spat, Bajram Ljatifi, Ergit Qeli.

SKQZ: Enis Halimi, Krye shëf i SKQZ. Miradije Mavriqi, drejtoreshë e ZRPPC. Përkthyesë: Vera Dula.

Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi (ZLKMP).

---

### **RENDI I DITËS**

1.Hyrje: z. Adnan Rustemi, kryesues i mbledhjes së KQZ -së.

*Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të KQZ-së nr 44/2017;*

2.Aktivitetet e ZRPP-së;

*Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimit të ZRPP-së për de certifikimin e kandidatëve të cilët kanë bërë kërkesë për tërheqje nga listat e certifikuara të Subjekteve Politike.*

*Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimit për certifikim të kandidatëve;*

*Rekomandim për akreditimin e vëzhguesve për zgjedhjet lokale 2017*

3.Raport i Këshillave;

-Këshilli për Buxhet dhe Financa

-*Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës për transferin e mjeteve;*

-*Shqyrtimi dhe miratimi i shpenzimeve për zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Kosovës 2017;*

Komiteti i Auditimit

*Njoftim nga Komiteti i Auditimit lidhur me Raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit*

4. Të ndryshme

---

### **1.Hyrje: z. Adnan Rrustemi, kryesues i mbledhjes së KQZ -së**

*Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të KQZ-së nr 44/2017*

**Adnan Rrustemi:** Përshëndetje të gjithëve, anëtarë të nderuar, përfaqësues të mediave etj. Më lejoni fillimisht që në përputhje me rregulloren e punës të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe me autorizimi të kryesueses së KQZ-ës, sot më përket me kryesuar mbledhjen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Mbledhja numër 48, do të ketë për rend dite këto pika, ju e keni marr materialin bashkë me rendin e ditës që përfshin shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit për mbledhjen numër 44, aktivitetet e ZRPP-ës me nënpikat brenda aktiviteteve të saj. Pikë e tretë e rendit të ditës, është Raport i Këshillave të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Këshilli për buxhet dhe financa dhe Komiteti i Auditimit. A keni diçka rreth rendit të ditës ndonjë propozim, vërejtje? Urdhëro zoti Vishi...!

**Eshref Vishi:** Po kryesues, ne sapo përfunduar mbledhjen e Këshillit për Buxhet dhe Financa dhe kemi shqyrtuar një pikë të rendit të ditës e cila, duhet të jetë pjesë e këtij rendi të ditës të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe, ajo ka të bëjë më shqyrtimin dhe miratimin e shpenzimeve për zgjedhjet e parakohshme, rishikimin e buxhetit të kërkuar nga Qeveria e Kosovës. Shqyrtimi i rishikimit të buxhetit të KQZ-ës për vitin 2017.

**Adnan Rrustemi:** Faleminderit, do të thotë është propozim në emër të Këshillit për Buxhet dhe Financa tek pika e tretë, të Raportimet e Këshillit për Buxhet, si pikë e veçantë “Shqyrtimi dhe miratimi i rishikimit të buxhetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve...”. Nëse dikush tjetër nuk ka, unë vetëm tek nënpika e tretë të “aktivitetet e ZRPP-ës”, mendoj që nuk duhet të përfshihet si e tillë, d.m.th., kjo kërkesa në këtë rast...

**Bajram Ljatifi:** Kryesues, a ka kërkesa të tjera zyra...”Lista serbe”...?, nuk ka...?

**Adnan Rrustemi:** Nuk ka kërkesa tjera, ndërsa aktivitetet e tjera le të realizohen nga zyra në përputhje me obligimet që i kemi me ligj, d.m.th., nuk është që kërkon vendimmarrje nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, për sa kohë nuk kërkon vendimmarrje asnjë rast nuk kemi pse me përfshi në rend të ditës. Atëherë, duke e konstatuar që me mungesën e kryesueses së KQZ-ës dhe të dy anëtarëve të tjerë në këtë rast unë e hedh në miratim rendin e ditës, kush është për? Kundër nuk ka, abstenim nuk ka.

*Anëtarët e KQZ-së, miratuan rendin e ditës.*

**Adnan Rrustemi:** Ju faleminderit. Atëherë vazhdojmë me pikën e parë, shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit për mbledhjen numër 44. A keni diçka për të shtuar, ndonjë vërejtje, sugjerim, plotësim? Atëherë pasi nuk ka vërejtje kush është për?

*Anëtarët e KQZ-së, miratuan procesverbalin e KQZ-së nr 44/2017*

## **2.Aktivitetet e ZRPP-së**

### *1.Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimit për certifikim të kandidatëve*

**Miradije Mavriqi:** Faleminderit kryesues. Të nderuar anëtarë të KQZ-ës. Zyra ka përgatitur rekomandimin për certifikimin e kandidatëve të cilët zëvendësojnë kandidatët të cilët janë de certifikuar në mbledhjen e KQZ-ës mbledhjen e fundit. Pas pranimit të aktgjykimeve përfundimtare nga ana e Këshillit Gjyqësor të Kosovës subjektet politike në afatin e përcaktuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve kanë zëvendësuar kandidat të cilët kanë qenë të dënuar në tri vitet e fundit për të garuar në zgjedhjet lokale.

Zyra me këtë rast, tha Mavriqi, ka pranuar dhe ka proceduar dokumentacionin e 63 kandidatëve për zëvendësim nga 12 subjekte politike. Ju i keni në rekomandim d.m.th. bashkangjitura të gjitha edhe subjektet politike edhe emrat e kandidatëve të cilat nuk po e shoh të arsyeshme ti listoj, mirëpo u rekomandoj që këta të certifikohen pasi i kanë plotësuar të gjitha kushtet siç janë nënshkrimi i të gjitha formularëve të bashkangjitur që nevojiten për certifikim. Ky është rekomandimi i zyrës faleminderit.

**Adnan Rrustemi:** Sa për informacion për anëtarët e KQZ –ës , zyra kaloj te pika e dytë në një far mënyre d.m.th. tek shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimit për certifikim të kandidatëve, si do që të jetë në përputhje me rekomandimin e zyrës, e kemi rekomandimin për certifikimin e kandidatëve të de certifikuar në mbledhjen e kaluar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. I kemi materialet e bashkangjitura duke përfshirë numrin e kandidatëve për secilin subjekt politik dhe emrin e secilit kandidat. Megjithatë unë po ju lexoj vetëm të dhënat kryesore në listën e subjekteve politike, kemi rekomandimin që të certifikojmë 14 kandidatë nga Partia Demokratike e Kosovës, 9 nga Lidhja Demokratike e Kosovës, 5 nga Lëvizja Vetëvendosje, 2 nga Aleanca Kosova e Re, 13 nga Aleanca për Ardhmërin e Kosovës, 4 nga Partia e Drejtësisë, 4 nga Nisam për Kosovën, 1 Lëvizja për Bashkim, 5 Lista Serbe, 1 Vizioni për Drenasin, 3 Partia Demokratike e Ashkalive të Kosovës, 2 Partia Shqiptare Demokristiane e Kosovës. Nëse anëtarët nuk kanë diçka për me shtuar rreth kësaj çështje, unë i kisha hedh në votim.

**Betim Gjoshi:** Faleminderit. Po, ne po flasim për zëvendësimin e 86 personave që i kemi larguar në mbledhjen e kaluar, unë me sa po shoh vetëm 63 i kanë sjell, pjesa tjetër d.m.th., nuk kanë shpreh dëshirë me i zëvendësuar, se ne nuk kemi më mundësi me i zëvendësuar...?

**Adnan Rrustemi:** Drejtoresh, a ke me dhënë ndonjë shpjegim në çështjen që u ngritë d.m.th, ne i kemi larguar 85...

**Miradije Mavriqi:** Në mbledhjen e fundit Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka de certifikuar 85 kandidat për arsye se, i kanë ardhur nga gjykata aktgjykimet e formës së prerë. Subjektet politike kanë qenë të njoftuara për afate edhe mundësin e zëvendësimit të këtyre kandidatëve, mirëpo të gjithë nuk kanë shprehur dëshirë që këta kandidat ti zëvendësojnë për atë edhe janë vetëm 63 kandidat do të thotë që zyra rekomandon që të certifikohen nga këto subjekte politike që ju i lexuat më parë...

**Adnan Rrustemi:** Dikush tjetër. Urdhëro zoti Vishaj...!

**Eshref Vishi:** Pyetje për zyrën, e përmendi afatin i cili ju ka komunikuar subjekteve politike që për zëvendësimin e kandidatëve, çka nëse eventualisht në procesin e ankimit një kandidat rikthehet prapë në garë. A ka të drejtë të zëvendësoj subjekti politik...?

**Miradije Mavriqi:** E kemi një plan operacional të miratuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. Zgjedhjet e kanë një far afati që do të thotë kur do të mbahen, e kjo ankesat e një kandidati të vetëm ose dy sigurisht që nuk kishte me anuluar ose nuk kishte me dezorientuar edhe qytetarin nëse, gjykata po e zëmë e dorëzon një vendim në favor të atij kandidati. Unë besoj që edhe pse fillon fushata është pak delikate kjo do të thotë ky afat, mirëpo edhe pse e fillon afati i fushatës unë kujtoj që është kandidati ka me qenë ndoshta i shkurtohet afati për fushat se për ndryshe nuk e di se si do të veprohet në këtë rast, ne nuk kemi pasur raste të tilla. Sepse janë broshurat që duhet të publikohen.

**Eshref Vishi:** I kemi parasysh ne edhe planin operacinal të zgjedhjeve, mirëpo duhet me pas parasysh edhe të drejtën e çdo kandidati i cili, është de certifikuar në ankesat të cilat i ja jep ligji, ato duhet të përfillen...

**Adnan Rrustemi:** Unë mendoj që zyra duhet me pas një përgjigje më konkrete dhe të bazuar në ligj. Për mu më e ndërlikuar se sa eventualisht kthimi vendimi i favorshëm në instanca tjera për ndonjë kandidat është për rastet të cilat kanë ankuar, janë në proces të ankimit edhe marrin përgjigje refuzuese, ndërkohë subjektet politike nuk i kanë pru zëvendësimet. Kësi raste mundemi me pas më të shpeshta do të thosha, unë nuk mendoj që duhet me ju referuar shumë planit operacional për me pas një përgjigje, se ne sot po i certifikojmë ç 'është e vërteta por, praktikisht me sa jam në dijeni sot fillon afati i ankesave në Gjykatë Supreme. Mirë, atëherë unë po e hedhë në votim ne po i certifikojmë këta që i kemi sot ndërsa, kjo qështje paraqet rëndësi për diskutim.

**Ilir Gashi:** Po mendoj që është një pjesë e konsiderueshme faktikisht e atyre që kanë ankuar në vendimmarrjen ton edhe vendet e zbrazëta që partitë politike nuk i kanë plotësuar ndoshta si pasoj kryesisht e ankimit që kanë bërë, ne do ti marrim në konsideratë deri në atë masë ku nuk dëmtohet procesin në qoftë se eventualisht, një vendimmarrje tjetër mund ta kthej si të domosdoshme ankesën e secilit nga ata. Kështu që nuk hi në një proces i cili, mund të cenohet pavarësisht kthimit të përgjigjes që mund të marrin ata, atëherë mund ti marrin parasysh në të kundërtën ne vazhdojmë me procesin.

**Binak Vishaj:** Kur i kemi de certifikuar këta kandidat të cilët na kanë ardhur aktgjykimet e formës së prerë prej Këshillit Gjyqësor ne ju kemi bërë thirrje edhe qytetarëve dhe organizatave joqeveritare dhe të gjithë të interesuarve se në rast se ka ndonjë kandidat që ata kanë dëshmi të bazuar të cilët janë të dënuar në vendim të formës së prerë, e që mund të ankohen e të sjellin ankesa në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve të kërkohet prej Këshilli Gjyqësorë që për ata kandidat të caktuar të merret aktgjykimet e formës së prerë. Në rast se aktgjykimet janë të formës së prerë ata kandidat duhet të hiqen, pse ka

standard ose duhet të vendoset i plotë ose, nuk ka kuptim në rast se nuk vendoset i plot. Kështu që, unë me sa e di ka pas edhe ka me pas kësi ankesa, është mirë mi trajtuar me kujdes sepse ne vet ju kemi bërë thirrje qytetarëve ta bëjnë një ankesë tillë, dhe këto ankesa t'i drejtojmë të Këshilli Gjyqësorë në mënyrë që t'i marrin aktgjykimet në formë sprint prej tyre edhe ta shohin se a janë të qëndrueshme dilemat që kanë ngrit qytetarët për kandidatët në fjalë.

**Miradije Mavriqi:** Atëherë, zyra kërkon një afat deri kur mundet me i pranuar ato kërkesa në mënyrë që me ju drejtuar Këshillit Gjyqësorë sepse kishte me ndodh në afat të pa limituar, të pacaktuar. Qytetari kujtohet ndoshta pas një jave me b'a një kërkesë të tillë...

**Binak Vishaj:** Për këtë çka e thash unë drejtoresh e kemi një ankesë që është edhe në rend të ditës edhe që propozuam me heq me komunikuar ju. Të paktën për këtë po them që ju ti drejtoheni Këshillit Gjyqësorë dhe, ta merrni një dosje të plot për pretendimet e qytetarit i cili, nuk mendon që ky nuk do të duhet të jetë i certifikuar. Të paktën për këtë, e kemi dhe ka bërë ankesë dje, nëse vendosim një afat tjetër atëherë është në rregull...

**Adnan Rrustemi:** Për me konkretizuar d.m.th., ne në radhë të parë e kemi rekomandim nga zyra për certifikimin e kandidatëve të cilët i prezantuam si rezultat ose pasoj e de certifikimeve që i kemi bërë në mbledhjet e kaluara. Unë po e hedhin në votim kush është për certifikimin e këtyre kandidatëve, zyra na njoftoj që kandidatët i plotësojnë të gjitha kushtet edhe janë në përputhje me ligjin që ti procedojmë. Në ndërkohë, jam që me vazhduar diskutimin se pari për me sqaruar këtë çështjen që u ngrit nga Betimi pjesërisht, nga Eshrefi dhe Iliri...Ne, duhet me diskutuar pak se çfarë do të ndodh me kandidatët të cilët janë në proces të ankesave. Unë po e them mendimin tim: më pak e ndërlikuar është për rastet që e fitojnë në Gjykatë në shkallën e dytë, se për mua është e padiskutueshme që duhet me i rikthyer në garë. Sidomos për rastet që nuk janë zëvendësuar duhet me pas parasysh se këto dhe subjektet politike mbajnë një përgjegjësi se si i kanë proceduar rastin e kanë zëvendësuar ose jo por, duhet me diskutuar edhe për rastet tjera të cilët eventualisht, janë në proces të ankesave dhe subjektet politike nuk kanë pru zëvendësime dhe çka ndodh pas shterimit të komplet procedurës së ankesës.

A do të kenë mundësi të zëvendësimit ose jo ne duhet me vendos një kufi, do të thosha unë...? Te trajtimi i këtyre çështjeve, ngjashëm e kam qëndrimin edhe me rastin që ngriti zoti Vishaj...Ne, nuk mundemi në pafundësi me lënë këtë proces si me thënë të ngritjes së rasteve si me thënë drejtimit në KGJK për sqarime. Unë, jam për këtë rast në rregull është le të procedohet por, nuk mundemi në pafundësi m'i lënë këtë punë ne duhet me vendos një kufi kur përmbillet procesi le të ndjekjen në instanca tjera. Atëherë, a jeni dakord që ti votojmë këta kandidat si zëvendësime e pastaj vazhdojmë diskutimin.

Atëherë, kush është për që ti certifikojmë? Ju faleminderit. Kundër nuk ka, abstenim nuk ka.

*Anëtarët e KQZ-së, aprovuan unanimisht rekomandimin për certifikimin të kandidatëve*

**Adnan Rrustemi:** Vazhdojmë diskutimin...

**Betim Gjoshi:** E para është mirë ta dimë të gjithë që organi kryesor që merret me ankesat e kandidatëve që është Paneli Zgjedhor për ankesa parashtrësia i ka refuzuar të gjithë kandidatëve. Ne tash e kemi edhe një shkallë që është procedura në gjykatë të rregullt që është Gjykata Supreme. Kjo në qoftë se sot është afati i fundit me i ankimue këto vendime se dje janë marr vendimet i bije që maksimalisht edhe tri ditë duhet të merr vendim edhe ne këtë mund ta presim. Por, për personat të cilët dëshmohet që kanë qenë në

procedurë të ankesës edhe cili do që të jetë vendimi d.m.th., ne ta zbatojmë. Në qoftë se kuptohet subjektet politike kanë gatishmëri, edhe unë mendoj e fundit, duhet të jetë dita e martë që i bije të jetë fundit..., ku ne duhet të merremi me kandidat. Më tutje ndodhi qka ndodhi se ne nuk mundemi mu marr më me ta se na shkaktojnë probleme në proceset e tjera zgjedhore. Në qoftë se ju kujtohet kur kemi marr vendim për mi de certifiku ju kam thënë që edhe me atë vendim ne një prej arsyeve ka qenë që kemi pas dilema ka qenë edhe rrezikimi i procesit, se është e vërtet se kjo mund me fituar në Gjykatë Kushtetuese një prej tyre pas zgjedhjeve po them shprehimisht se për supremen po e dimë epilogun të gjithë si është , mendimi im është se vendimi jonë është bazuar në ligj të zgjedhjeve edhe at anë ligj të zgjedhjeve i kthejnë ankesat edhe përgjigjet.

Nuk besoj, tha z. Gjoshi se supremja dhe as PZAP-i kanë autoritet me kaluar më shumë se sa ligjin e zgjedhjeve, e organet tjera siç është Gjykata Kushtetuese, ata e shohin në të gjitha dimensionet... Pra, kjo mendoj se është afati i fundit, e martja që ne është dashur të merremi me këtë temë...Në qoftë se eventualisht ka ndonjë interesim, unë më shumë e kam parë si mos interesim të subjekteve se sa që është ndërlidhur me ankesa por, cilido që të jetë nuk po flas në emër të askujt, ky duhet me qenë afati i fundit kur ne merremi me këtë temë, sepse fillon votimi jashtë vendit dhe ua zvogëlojmë qytetarëve jashtë vendit periudhën për me votuar, mandej m'i prodhuar broshura ato çka i prodhojmë d.m.th., ju merr kohë sepse po flasim për 7000 kandidatë....

**Eshref Vishi:** Ne, nuk mundemi të prejudikojmë vendimet e Gjykatës Supreme. Mirëpo, megjithatë për dy rastet edhe për rikthim edhe zëvendësimin e kandidatëve nga subjekte politike, duhet të vlej ky afat....

**Adnan Rrustemi:** Natyrisht që ne nuk mundemi ti prejudikojmë, por megjithatë duhet të diskutojmë si institucion brenda përgjegjësive tona se si po e operacionalizojmë këtë aktivitet. Ne, duhet me përmbyll në kuptimin që mos mu cenuar aktivitet e tjera. madje unë mendoj që nuk ka pse me u varë gjithqysh mi identifikuar pak edhe komunat nga të cilat vijnë këta kandidat që mos me mbajt peng komplet procesin e votimit po edhe jashtë vendit, se ditët kur fillon ky aktivitet po afrohen nëse nuk përfundon gjithçka. Unë, e thash për rastet gjykata supreme, eventualisht mundet me marr vendim pozitiv ndaj ankesave nuk ka asnjë dyshim se ne duhet ti përfshijmë, ti kthejmë në listë, unë kam qëndrim si me thënë afirmativ edhe për rastet që kanë ankuar dhe eventualisht marrin përgjigje negative nga gjykata supreme që subjektet politike me pas mundësi me i zëvendësuar, por edhe për këtë duhet marrim e sidomos për të dytën nëse refuzohen ankesat e subjektet politike nuk i kanë sjell sot kandidatët për certifikim duhet me marr një qëndrim dhe me përcaktuar një datë se deri kur ne mundemi me konsideruar proces në funksion të zëvendësimit. Le të përlllogaritet afati ligjor i shqyrtimit 72 orë nga gjykata supreme, dhe le të jetë dita kur atje përfundon dhe subjektet politike i kanë përgjigjet e qarta nga gjykata supreme kur ne me gjithat mundemi me bo zëvendësim respektivisht certifikim të kandidatëve. E kam hallin për disa nga subjekte politike të cilat kanë sjell pak kandidatë sot e që ju kanë de certifikuar shumë më shumë, nëse është vullnet i tyre siç u tha për mos me bo zëvendësimet edhe për këtë është mirë me na u sqaruar mbase edhe në komunikim nuk është se e kemi si obligim edhe ne si institucion e as zyra me marr përgjigje të prerë nga subjekte politike a e kemi ndërmend me i zëvendësuar të gjithë ose jo, por ne duhet me përcaktuar një datë edhe nëse e marte përputhet me periudhën e shqyrtimit në gjykatën supreme po e vendosim të martën si ditën e fundit kur ne bëjmë certifikim të kandidatëve respektivisht për këto raste si zëvendësime.

**Binak Vishaj:** Kryesues, e marta e përmbush 72 orëshin e Gjykatës Supreme që mundet me marr vendime për ankesat eventuale. Gjithashtu, edhe ne po e vendosim këtë afat edhe për këtë pjesën që na si

institucion duhet me ba vendime, edhe thirrje siç ju kemi bërë publikisht: kush ka diçka për kandidatët e certifikuar me sjellë... Edhe duhet ta bëjmë publike se, deri të martën është afati i fundit që mundet me u kryer procesi i certifikimit sepse, atëherë nuk po i përmbahemi afatit operacional të zgjedhjeve, atëherë po ju hymë borxh operacioneve të tjera zgjedhore.

**Adnan Rrustemi:** Veç për me sqaruar, se unë jam dakord për rastet që ngritën dhe vërtetohen që janë në kundërshtim me ligjin. Por, kjo puna e thirrjes ton e para është si me thënë thirrje nuk është se një aktivitet i bazuar në ligj. Edhe e dyta thirrja ka ndodh para se me ndodh certifikimi, unë nuk jam me lanë pa fundosi këtë proces, por po mendoj që si e kemi qasjen, secili le të sqarohet ne këto raste dhe deri të martën le të përmbillet secili rast konkret se po na zvarrit, sa po e mbyllim një çështje po na hap një rast tjetër në natyrën e njëjtë. A po pajtohemi që e marta le të jetë dita e fundit kur subjektet politike mundem mi bo zëvendësimet qoftë edhe rikthimet e kandidatëve të cilët e fitojnë të drejtën e tyre si rezultate të ankesave. A jeni dakord?

**Betim Gjoshi:** Unë të jam i qartë, vetëm ata që janë në proces të ankesave, jo tjerët se kanë qenë 18 vetë në proces të ankesave. Në qoftë se prej tyre ka, si e fitoj si nuk e fitoj prej subjekteve, vetëm ata emra, jo për tjerë që mos ta bëjmë këtë.

**Adnan Rrustemi:** Për rastet që kanë paraqitur ankesa dhe ndonjë rast në përputhje me ligjin. Me pikën tjetër nga zyra që ishte pika e parë në fakt, shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimit të ZRPP-së për de certifikimin e kandidatëve.

## 2. Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimit të ZRPP-së për de certifikimin e kandidatëve të cilët kanë bërë kërkesë për tërheqje nga listat e certifikuar të Subjekteve Politike.

**Miradie Mavriqi:** Faleminderit kryesues. Zyra, ka përgatitur një listë të kandidatëve të cilët kanë bërë kërkesë në zyrë për tërheqje nga listat e subjekteve politike. Subjektet politike do të thotë kanë qenë të njoftuara dhe për ata kandidatë të cilët nuk dëshirojnë të marrin pjesë në zgjedhje për arsye të ndryshme siç janë vendimet si pasoj humbja e vendit të punës apo edhe arsye shëndetësore. Zyra rekomandon që të de certifikohen 5 kandidat i keni në rekomandim, nuk e di a ka nevojë ti lexojmë apo vetëm si numër po ju them që janë 5 kandidat. Vetëm desha t`ju njoftoj nëse miratohet ky de certifikim atëherë kanë dorëzuar edhe subjektet politike menjëherë edhe kandidat të tjerë nëse ofrohet mundësia e zëvendësimit të tyre, faleminderit.

**Adnan Rrustemi:** Faleminderit drejtoresh, mesa po e kuptoj se ky materiali tjetër rekomandimi për certifikim të kandidatëve, është i ndërlidhur me këtë rekomandimin për de certifikimin.

**Betim Gjoshi:** Ne, i kemi 5 kandidatë që pi de certifikojmë, janë 3 që kanë ardhur për zëvendësim por për njërin prej subjekteve që ka pruar për ta zëvendësuar nuk po e shohim kënd po e largojmë, nuk e kemi në listë ose e keni harruar ose nuk po di si ka rrjedhur.

**Adnan Rrustemi:** Unë duhem me konkretizuar: E kemi rekomandimin për de certifikimin e 5 kandidatëve nuk po jep emrat edhe pse nuk ka asgjë të keqe por janë 2 nga Partia Demokratike për të cilët 2 i ka sjellë zëvendësime, është një nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës për të cilën nuk ka rekomandim për zëvendësim edhe një tjetër nga Lëvizja për Bashkim po ashtu për të cilën nuk ka

rekomandim për zëvendësim edhe një tjetër nga Nisma për Kosovën për të cilën po ashtu nuk ka rekomandim për zëvendësim. Ndërkohë e kemi një rekomandim për zëvendësim nga Lidhja Demokratike e Kosovës e i cili mungon te rekomandimi për de certifikim. Unë po e hedhë në votim, nëse eventualisht mendoni që është në rregull këta 5 për de certifikim mos është duke ju munguar ndonjë. Mirë atëherë LDK-ja çka po zëvendëson, kë po e zëvendëson LDK-ja, nuk jemi duke e de certifikuar. Veç nëse është ndonjë zëvendësim i ndonjë de certifikimit të mëparshëm të tërheqjeve të tjera. Atëherë, kush është që ti de certifikojmë 5 kandidatët e mëparshëm në rastin konkret.

**Binak Vishaj:** A janë të informuara partitë politike për zëvendësimin e këtyre kandidatëve edhe nuk i kanë sjell emrat.

**Adnan Rrustemi:** Kush është për edhe një here? Ju faleminderit, kundër nuk ka abstenim nuk ka.

*Anëtarët e KQZ-së, unanimitisht miratuan rekomandimin e ZRPP-së për de certifikimin e kandidatëve të cilët kanë bërë kërkesë për tërheqje nga Listat e Certifikuara të Subjekteve Politike.*

**Adnan Rrustemi:** Vazhdojmë me rekomandimin për dy zëvendësime, një nga LDK për rastin që e kemi pasur për de certifikim nga mbledhja e kaluar. Kush është për që të certifikimin e tre kandidatëve konkret...?

*Anëtarët e KQZ-së, miratuan këto zëvendësime*

### 3.Rekomandim për akreditimin e vëzhguesve për Zgjedhjet Lokale 2017

**Miradije Mavriqi:** Faleminderit kryesues. Zyra, ka përgatitur rekomandimin për akreditimin e vëzhguesve kjo është grupi i parë. Në bazë të nenit 54.1 të ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, nenit 19 për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës nenit 3 të rregullës zgjedhore nr. 07/2017, vëzhguesit e zgjedhjeve si dhe planit opercional të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve deri me 15 shtator janë proceduar aplikacionet e vëzhguesve, nga një organizatë ndërkombëtare që ka aplikuar për akreditim të vëzhguesve dhe një organizatë jo qeveritare me gjithsej 30 vëzhgues. Ju i keni të renditura edhe emrat e vëzhguesve janë plotësuar gjitha kushtet e parapara me ligj, kështu që zyra rekomandon që të akreditohen këta vëzhgues faleminderit.

**Adnan Rrustemi:** Faleminderit drejtoresh. Unë i hapi diskutimet nëse anëtarët kanë për të shtuar diçka në këtë aspekt.

**Betim Gjoshi:** Faleminderit kryesues, na para vetës sot i kemi 30 vëzhgues por ajo që më gëzon fakti që misioni i Bashkimit Evropian ka vendos që ti vëzhgoj edhe zgjedhjet lokale edhe për këtë i falënderoj në të njëjtën kohë shfrytëzoj rastin mi falënderuar edhe për një raport të balancuar edhe të mirë që kanë bërë për zgjedhjet e përgjithshme edhe për të cilat ne jemi zotuar që aq sa mundemi do ti përmbushim këto zgjedhje për sa na përket neve si KQZ. Por, raporti siç e keni parë të gjithë nuk sjell rekomandime veç për KQZ-në, sjell rekomandime për të cilat duhet ndryshim ligji edhe rregulla të tjera edhe për pjesën tonë edhe një here i them sekretariatit ta ketë para vetës si udhë rrëfytes për aq sa është e mundur të përmbushin ato rekomandime të këtij raporti në këto zgjedhje lokale. E di që informimi prapë është problem, pjesën



tjetër mendoj që është dashur me pas parasysh se janë rekomandime të sakta, të qëndrueshme edhe që i kontribuojnë një procesi më të mirë zgjedhor, faleminderit.

**Binak Vishaj:** Edhe unë dua t'i gëzohem faktit që prapë Bashkimi Evropian që të sjell mision të vëzhgimit për zgjedhjet lokale, ndërsa që fokus i tyre më shumë janë zgjedhjet parlamentare. Gjithashtu, duhet përsëritë edhe ato që i tha kolegu, sepse gjetjet e këtij raporti për zgjedhjet parakohshme parlamentare, do jenë për neve në tavolinë...Do të mundohemi që në fazën më të madhe, t'i implementojmë ato gjetjet e raportit të vëzhgimit të Bashkimit Evropian në mënyrë që maksimalisht t'i minimizojmë që ato mos të na përsëriten, mos të na përsëriten situata sfiduese të cilat këta i kanë gjetur...

**Adnan Rrustemi:** Faleminderit...Ne, e kemi një pikë konkrete dhe një rekomandim konkret nga ZRPP-ja që është rekomandimi për akreditimin e dy organizatave vëzhguese me numrat prej 17 vëzhgues organizata e parë, dhe 13 organizata e dytë. Bëhet fjalë për misionin e Bashkimit Evropian, komisionin vëzhgues të Bashkimit Evropian dhe për organizatën Demokracia në Zhvillim me 13 vëzhgues. Unë, natyrisht që i bashkëngjitëm konstatimit dhe vlerësimit që monitorimi dhe vëzhgimi i procesit zgjedhor është një aspekt i integritetit në përgjithësi të zgjedhjeve, dhe të ketë sa më tepër vëzhgues, veçmas vëzhgues ndërkombëtar, por edhe nga shoqëria civile etj., dhe se të gjithë e rrisin besueshmërinë dhe janë kontribut në drejtim të një procesi të drejt...Shpresoj që misioni i BE-së, nuk do ta përmbyllë me këtë numër të vëzhguesve, e do të ketë numër shumë më të madh për ta mbuluar në mënyrë sa më gjithëpërfshirës territorin e vendit dhe vendvotimet. Megjithatë, unë po i hedh në votim këto dy organizata me vëzhguesit që ju i keni edhe emrat e secilit vëzhgues të bashkangjitur. Kush është për që ti akreditojmë misionin e BE-së, me 17 vëzhgues dhe organizatën për Zhvillim me 13 vëzhgues, ju faleminderit. Kundër nuk ka, abstenim nuk ka...

*Anëtarët e KQZ-së, unanimitisht miratuan rekomandimin e ZRPP-së për akreditimin e 17 vëzhguesve nga Bashkimi Evropian, dhe të 13 vëzhguesve nga organizata Demokracia në Zhvillim me 13 vëzhgues.*

### **3.Raport i Këshillave**

#### **Këshilli për Buxhet dhe Financa**

##### *1. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës për transferin e mjeteve*

**Illir Gashi:** Kryesues faleminderit, por le ta udhëheq Eshrefi për shkak se, skam qenë në mbledhje të Këshillit, ka qenë kryesues, udhëheqës...

**Eshref Vishi:** Faleminderit. Këshilli për Buxhet, i ka tre pika të rendit të ditës, këtu..., për shqyrtim dhe miratim. Nën një, e kemi shqyrtimin dhe miratimin e kërkesave për transferim të mjeteve. Janë nga dy programe, programi për Sekretariatit dhe Programi për zgjedhjet. Në programin e Sekretariatit, janë dy kërkesa për transfer që kanë të bëjnë me përcjelljen e mjeteve në nën kategorinë e regjistrimit të automjeteve në vlerë prej 100 euro, dhe ato merren nga nën kategoria e shpenzimeve komunale, konkretisht, ashtu është e definuar: energjia elektrike. Ndërsa, transferi i dytë, ka të bëjë me shpenzimet për vendimet e gjykatave në vlerë prej 3100 euro. Këto mjete, merren nga shpenzimet komunale nga e

njëta kategori. Ndërsa, tek programi i zgjedhjeve transferohen 3600 euro për qira dhe pajisje që merren nga shërbimet postare. Transferi i dytë, kërkohet te mirëmbajtja e mobileve dhe pajisjeve..., transferohen 900 euro për riparim të nxehtë në QNR, ndërsa mjetet merren nga nën kategoria e shërbimeve postare dhe rekomandojmë KQZ-në për miratimin e transferove.

**Adnan Rrustemi:** Faleminderit z. Vishi. Ne, e dëgjuam rekomandimin e Këshillit për Buxhet dhe Financa. Para se ta votojmë, unë jam dakord..., por këtë rekomandim që na prezantoi këshilli, do të ishte mirë që ta kishte secili anëtar si shpjegim, dhe jo veç si tabelë se, është e më lehtë me zbërthye se cila linjë, në cilën po transferohet edhe pse s'bëhet fjalë për shuma të madha. Atëherë, kush është për që të votohet ky rekomandim ? Kundër nuk ka, abstenim nuk ka...? Faleminderit...

*Anëtarët e KQZ-së, miratuan kërkesën e Këshillit për Buxhet dhe Financa për transferin e mjeteve*

## *2. Shqyrtimi dhe miratimi i shpenzimeve për zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Kosovës 2017*

**Eshref Vishi:** Si material, çdo anëtar i KQZ-së e ka pasur në elektronik, dhe Këshilli për Buxhet dhe Financa rekomandon miratimin e shpenzimeve për zgjedhjet e parakohshme të Kuvendit të Kosovës.

**Adnan Rrustemi:** Raportin, është e vërtetë për zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Kosovës, e kemi pasur secili anëtar të bashkangjitur në e-mail. Shpresoj që keni mbërri me shqyrtuar. Pra, e kemi rekomandimin e Këshillit për Buxhet dhe Financa që ta miratojmë. Nëse dikush ka me shtuar në lidhje me këtë...? Urdhëro z. Ercan...?

**Ercan Spat:** Faleminderit kryesues. Besoj se për opinionin e gjerë, është e rëndësishme me cek një fakt: Se, zgjedhjet parlamentare në Kosovë e kanë trendin e zvogëlimit të shpenzimeve në numër të votuesve. Ky trend, qysh prej 2010 po vazhdon edhe kësaj here, edhe pse dallimi nuk është shumë i madh por vazhdon... Faleminderit...

**Ilir Gashi:** Desha t'i them vetëm krye shefit se dje pas një takimi që kemi pasur në Qeveri lidhur me buxhetin e KQZ-së për zgjedhjet, është thënë se duhet t'i drejtohem me një shkresë e cila, do të duhet të jetë shumë urgjente. Për shkak të rishikimit të buxhetit për t'i kthyer mjetet për Zgjedhjet Lokale të cilat janë tërhequr dhe janë përdorur për Zgjedhjet e Përgjithshme të 11 qershorit...Kështu që shkresën, është mirë ta orientoni me kohë në mënyrë që të mos kemi probleme më tutje.

**Adnan Rrustemi:** Pajtohem me theksimin që e bëri z. Spat, për koston e procesit zgjedhor. Do të ishte mirë që për këtë pikë, ta kemi një analizë pak më shpjeguese për disa prej proceseve zgjedhore të fundit, për mënyrën se sa kanë kushtuar në nivel të përgjithshëm dhe për shërbime të veçanta d.m.th., për operacione e caktuara edhe për aktivitetet e veçanta, dallimet eventuale, p.sh., sa ka kushtuar shërbimi votuesve në tërësinë e vet në 2017, dhe sa ka kushtuar në 2014, ose në bazë të natyrës së njëjtës zgjedhore se ka shumë rëndësi me pas një analizë të tillë. Po, a mundemi me konstatuar se, është pikërisht kjo: 2.10 cent për kokë të votuesit si kosto....? Është mirë të kemi një analizë më të gjerë për faktin se, ne kemi shtim të numrit të votuesve, por me pa pak edhe në kuptimin e votuesve që marrin pjesë në zgjedhje...Ne, e bëjmë analizën pak ma të saktë se, ne e dimë që kemi probleme me lista të votuesve, po me e ngushtuar bazën e krahasimit për me pas edhe konstatimin sa më të saktë.

Ne, tha Rrustemi, duhet ta miratojmë raportin si të tillë se, është rekomandim. Atëherë kush është për? Kundër nuk ka, abstenim nuk ka....

**Eshref Vishi:** Unë propozova një pikë të rendit të ditës, ishte një far forme urgjente për sot që ka të bëjë me shqyrtimin e rishikimit të buxhetit të KQZ-së për vitin 2017. Si akt, ky rishikim i buxhetit është kryer, e kemi përfunduar në korrik, saktësisht me datën 10 korrik të këtij viti. Mirëpo, ndërkohë kemi edhe një qarkore dhe një kërkesë nga Ministria e Financave, nga qeveria aktuale, një shkresë të pranuar me datën 15.09.2017 ku kërkohet rishikimi për vitin 2017 në kuptim të identifikimit të kursimeve të mundshme në të gjitha kategoritë e shpenzimeve. E dyta, të paraqiten të gjitha kërkesat për transfere të mundshme dhe riakolime të mundeshe të organizatave buxhetore dhe të institucioneve. Këshilli për Buxhet dhe Financa, e ka shqyrtuar kërkesën dhe e rekomandon KQZ-në.... Pasi jemi në proces zgjedhor, rishikimi i buxhetit procedohet ashtu siç është aprovuar dhe është dërguar në Ministrin e Financave më 10 korrik të këtij viti, njëjtë, të mos preket... Dhe, sa i përket kërkesës së dytë që ka të bëjë me transfere dhe riakolime, administrata do ta procedoj, varësisht prej nevojave që ka brenda institucionit tonë. Rekomandohet të miratohet si i tillë...

**Adnan Rrustemi:** Dikush tjetër, urdhëro kryeshef...

**Enis Halimi:** Veç një plotësim, sepse u tha nga kryesuesi: Ky ka qenë rishikim që është i bazuar, që kemi larguar edhe disa aktivitete nga plani i punës në muajin korrik, që kemi bërë një lloj rishikimi të planit të punës dhe i kemi modifikuar, ri formatuar ato aktivitete që kemi vlerësuar që është e vështirë që të realizohen ashtu sikurse ishin projektuar në fillim të këtij viti për shkak të rrethanave në të cilat u gjetëm për organizimin e zgjedhjeve të parakohshme. Pra, ky i përmban ato, është komfor atyre anulimeve të atyre aktiviteteve dhe nevojave tona të Sekretariatit për çështje orientimi të mjeteve në disa dimensione të tjera...Po ashtu, ky përmban atë që tha z. Gashi, vë në pah nevojën për rikthim të asaj shume që është marrë për organizimin e zgjedhjeve të parakohshme.... Pra, këto i përmban në faqen 7 raporti si kërkesë..., që gjatë shqyrtimit m'u b'a procedimi i këtyre mjeteve në llogarinë tonë. Pra, këtu është e përmbledhur...Ju faleminderit...

**Binak Vishaj:** Duke e pasur parasysh se tash shteti është në rishikim të plotë të buxhetit edhe gjitha institucionet kanë marrë një ftes të këtillë për rishikim, atëherë Qeveria ka bërë thirrje që edhe ne të jemi në një takim sa më të shpejt me Ministrin e Financave që ta kenë të qartë...Ajo që neve na është marr buxhet i ndarë nga zgjedhjet lokale për zgjedhjet parlamentare, dhe mos të mbesim keq pas rishikimit për institucionet e tjera...Dhe, ishte kërkesë e Kryeministrit që na të shkojmë sa më shpejt në Ministrin e Financave, dhe mos të mbesim keq si KQZ për mjete, në mënyrë që operacionet zgjedhore të parapara me plan operacional të mos mundemi t'i realizojmë për shkak se nuk i kemi mjetet...

*Anëtarët e KQZ-së, miratuan shpenzimet për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Kosovës 2017*

#### **4. Komiteti i Auditimit**

*Njoftim nga Komiteti i Auditimit lidhur me Raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit*

**Binak Vishaj:** Faleminderit kryesues. Atëherë, raporti i Zyrës Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës që përmban pasqyrat financiare për vitin 2016, dhe që përfundon me 31 dhjetor të vitit 2016, është pranuar në KQZ në muajin qershor të vitit 2017. Ky raport, u është vendosur në dispozicion të gjithë stafit të Sekretariatit të KQZ-së. Në Komitetin e Auditimit, është diskutuar edhe aprovuar plani i zbatimit të rekomandimeve të zyrës Kombëtare të Auditimit. Këtë të mërkure, me datën 13, Komiteti ynë ka diskutuar për raportin dhe konstatim i përgjithshëm i të gjithë anëtarëve të cilët ishin prezent, ishte se raporti përmban dobësi, ndonëse deri më tash janë bërë përmirësime në shumë fusha. Këto dobësi, nuk janë të fushave të veprimit të shkallës së lartë të rrezikut... Dobësitë e prezantuara, janë qeverisja që ka të bëjë me zbatimin e pa mjaftueshëm të rekomandimeve të zyrës Kombëtare të Auditimit, listën e reziqeve që ende nuk është finalizuar dhe aprovuar në KQZ, vetëvlerësimin dhe zbatimin e rregulloreve... Po ashtu, zyra Kombëtare e Auditimit ka gjet edhe kontrollin e brendshëm dhe financiar që përfshin çështjet e procedurave të pagesave, menaxhimin e pasurive jo financiare, rekrutimin e stafit të ri dhe vazhdimin me ushtrues detyre, si dhe vonesat në kryerjen e obligimeve tjera. Ne, jemi këtu prezent, komiteti i auditimit, kryeshefi është... Këtu është edhe auditori i brendshëm, dhe jemi të gatshëm që t'ju japim sqarime për gjitha kërkesat e juaja në rast se, ka nevojë dikush diçka për shpjegime shtesë...

**Adnan Rrustemi:** Faleminderit z. Vishaj. Ishte njoftim nga komiteti i auditimit për raportin vjetor të auditimit. Nëse eventualisht keni ndonjë pyetje, ndonjë çështje për t'u sqaruar, unë në emër të komitetit për ta ngritur urdhëroni... Nëse jo, i dëgjuam vlerësimin nga komiteti, është një vlerësim pozitiv në pjesën më të madhe me gjithat adreson disa prej rekomandimeve që nuk kanë gjetur adresim adekuat për gjatë viteve, që është një përgjegjësi për KQZ-në e sidomos për Sekretariatit që të ketë një vëmendje të shtuar në këtë aspekt. Ne, nuk do ta miratojmë, është vetëm njoftim....

#### **5. Të ndryshme**

Në të ndryshme e kemi pikën e fundit, a ka dikush diçka...? Nëse jo, unë e kam një çështje të shkurtër jo për ta diskutuar por, është më shumë se një kërkesë për Kryeshefin. Nuk është se nuk e kemi diskutuar me anëtarët në raste të tjera, bëhet fjalë për çështjet e Informimit Publik, për strategjinë e informimit, për vështirësitë që na kanë dalë si institucion në realizimin e strategjisë së Informimit Publik. Për shkak të procedurave të prokurimit, unë nuk jam sot për ta diskutuar por personalisht, e kam një kërkesë për Kryeshefin që të na e përgatit një raport të tërësishëm, për komplet këtë aspekt: ku ka ngecur se, ne po u afrohem ditëve të zgjedhjeve dhe në ndërkohë, nuk kemi realizuar thuajse asgjë nga strategjia në kuptimin thelbësor të saj. Por, në të njëjtën kohë, ky raporti duhet të na afroje edhe vlerësime për zgjedhje alternative se, çka mundemi me b'a në ditët e fundit...

Janë operacionet thelbësore të procesit zgjedhor, tha z. Rrustemi. Për shembull: Si të votohet? Për mënyrën e votimit në tërësi. Ne..., duhet me gjet zgjidhje nëse OSHP-ja në këtë rast, i ka vendosur këto pengesa për procedura... Unë, nuk jam në dijeni dhe saktësi, ne duhet me gjet zgjidhje çka mundemi me bërë në këtë drejtim. Nëse jeni dakord që Sekretariatit të na përgatis një raport...

**Binak Vishaj:** Unë e kam vetëm edhe një kërkesë për drejtoreshën që pas komunikimit që të bëjë me Këshillin Gjyqësor për kërkesën që patëm më herët..., të na informoj se cila do të jetë përgjigja në bazë të aktgjykimit të formës së prerë që na sjell Këshilli Gjyqësorë...Për kërkesën e qytetarit që më herët vendosëm me komunikuar me ta...!

**Illir Gashi:** Faleminderit kryesues. Po mendoj që duhet të jenë dy raporte: Një raport duhet të jetë procedural se ku është gjendja sa i përket përzgjedhjes së operatorit i cili, do ta kryej informimin publik...Dhe ne si këshill, do ta bëjmë një raport se çfarë kemi bërë në mungesë të operatorit deri më tash në përputhshmëri me mundësit tona ligjore dhe me rregullat çka na lejojnë lidhur me informimin e opinionit publik sa u përket zgjedhjeve që do të mbahen...

**Adnan Rrustemi:** Dakord...Këshilli për Mbikëqyrjen e Fushatës së Informimit Publik, është mirë me e prezantuar punën e tij në çdo rast, dhe jam dakord që me i pas dy raporte. Por, për mua është e rëndësishme, sepse jam në dijeni çka kemi bërë si këshill për kundër pengesave në këtë aspekt, por na duhet një raport pak më tepër procedural dhe nga këndvështrimi i Sekretariatit se çka mundemi me b'a brenda ligjit në situatën qarë jemi...Se, nuk mundemi me përmbyll procesin pa e realizuar fushatë, sidomos për mënyrën e votimit...Nëse mendon Sekretariati me realizuar veprime që i modifikon produktet e zgjedhjeve të kaluara, në data dhe në emërtim të zgjedhjeve dhe i zbaton si procedurë ngase, nuk ndryshon shumë procedura për ato që nuk ndryshon, mirëpo ne, saktësisht duhet ta gjejmë një zgjidhje lidhur me ato që ndryshojnë...Për këtë e kisha fjalën, pra nëse jeni dakord që ta kemi një raport, në këtë rast dy raporte në mbledhjen e radhës të KQZ-së....

Atëherë nëse nuk keni diçka tjetër, ju falënderoj për kontributin e dhënë...

## **Për KQZ**

**Adnan Rrustemi, anëtar**

-----